



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

PPP.nr.01/2024

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik, si gjykatë përbarimore e shkallës së parë, gjyqtari Burhan Berisha, gjyqtar përbarues, duke vendosur në çështjen përbarimore të Kreditorit A. K. nga Kaçaniku të cilin e përfaqëson Avokat F. T. nga Kaçaniku kundër Debitorit K. K. D. A. , duke vendosur lidhur me Prapësimin e Debitorit, jashtë seancë gjyqësore, me datën 12.08.2024 dhe në të njëjtën ditë bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T V E N D I M

I.REFUZHET Prapësimi i debitorit K. K. D. A. , i ushtruar më datën 02.02.2024, kundër Urdhrit Përbarues me P.nr.61/2024, datës 29.01.2024, si i PA BAZUAR.

II.DETYROHET debitori që kreditorit të i'a paguajë shumën sipas propozimit për përbarim, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, të cilat do të llogariten nga përbaruesi privat, të gjitha këto pagesa do të bëhet në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit në dorëzim të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Kreditori A. K. nga Komuna Kaçanik, më datën 29.01.2024 tek përbaruesi private Sh. H L., me seli në Ferizaj, e ka dorëzuar propozimin për përbarim kundër Debitorit K. e K. D. e A..

Me këtë propozim, ka kërkuar, që të caktohet përmbarimi dhe të detyrohet debitori të ia paguaj borgjin në shumën prej 5,559.23€ këtë shumë me kamatë prej 8%, duke filluar që nga data 22.06.2021, e deri në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës kontestimore, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Përmbarusi Privat me datën 29.01.2024, ka nxjerr Urdhrin P.nr.61/2024, me të cilin e ka lejuar përmbarimin, po ashtu me këtë urdhër, e ka udhëzuar debitorin që në afat prej 7 ditësh, mundë të paraqes prapësim kundër urdhrin përmbarimor të përmbaruesit privat.

Debitori në afatin e paraparë ligjorë ka paraqitur Prapësim, me të cilin i ka propozuar gjykatës që të nxjerr aktvendim, me të cilin miratohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbarimor dhe të anulohen të gjitha veprimet e marra.

Përmbaruesi privat, një kopje të prapësimit të debitorit, ia ka dorëzuar kreditorit, me datën 02.02.2024, i cili në afatin e parapare ligjorë ka paraqitur përgjigje në prapësim ,me të cilin i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar, sepse i njëjti nuk është i mbështetur në prova.

Gjykata e refuzoi prapësimin e debitorit, si të pa bazuar, për arsye se debitori prapësimin, nuk e ka mbështetur në provat, asnjë provë nuk ja ka bashkangjitur prapësimit siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, si dhe nuk ka paraqitur asnjë nga shkaqet e parapara me nenin 71 nga pika 1.1 deri tek pika 1.12 të LPP-së. Prandaj gjykata duke i pasur për bazë të gjitha këto fakte të konstatuara vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Përmbaruesi privat, dorëzimin e propozimit për përmbarim, urdhrin dhe provave tjera, ja ka dorëzuar debitorit konform nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit të procedurës përmbarimore

Gjykata pas pranimit të propozimit, analizimit të provave të bashkangjitura, ka gjetur se propozimi për përmbarim, është i bazuar, në dokumentin përmbarimor siç është paraparë, me neni 22 par 1 pika 1,1 të Ligjit të procedurës përmbarimore, pra propozimin e ka bazuar në vendim përmbarues të Gjykatës.

Gjykata i analizoi pretendimet e kreditorit të paraqitura me propozim për përmbarim dhe këtyre pretendimeve u a fali besimin, sepse kreditori propozimin për përmbarim, e ka bazuar në

dokumentin përbarimor, siç është paraparë me nenin 22 par 1 pika 1,1 të Ligjit të procedurës përbarimore.

Gjykata i analizoi edhe pretendimet e të autorizuarit të debitorit, i cili i ka propozuar gjykatës që prapësimi të refuzohet dhe të shfuqizohet urdhri përbarimor. Gjykata ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar, nuk është i mbështetur në prova siç është paraparë në dispozitën ligjore të nenit 69. par.4 të LPP-së. Po gjykata ka gjetur se prapësimi nuk i plotëson kushtet e parapara me neni 71 nga pika 1-12, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata i detyroi debitorin të ja paguaj shumën si në propozimin për përbarim, shpenzimet e procedurës përbarimore të cilat do të llogariten nga ana e përbaruesit privat, sipas Udhëzimit Administrativ për Tarifat dhe Shpërblimet dhe Shpenzimeve për Përbaruesit Privat, si dhe për përpilimin e propozimit për përbarim sipas TOAK-së, si dhe konform nenit 13, par.4 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

Dega në Kaçanik

PPP.nr.01/2024 prej datës 12.08.2024

Gjyqtari,
Burhan BERISHA

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit, ankesa i parashtrohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.